

Standardi puro Serb me titull ***“Rregullorja mbi kërkesat teknike të shtesave për beton, llakut për beton, llaçit dhe bujakave për kabllot parandemëse”***.

Ky standard 27 faqësh, përcakton klasifikimin e shtesave për beton, kërkesat teknike mbi shtesat, deklarimin e performancës dhe udhëzimeve teknike, procedurën e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës, treguesit e konformitetit dhe shenjimit.

Në objektiv është harmonizimi me ***Rregulloren (EU) Nr 305/2011*** të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e cila përcakton kushtet e harmonizuara për tregtimin e produkteve ndërtimore.

Afati i fundit për marrjen e komenteve është ***24.04.2019***.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre.